



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.277/2022

Datë: 31 maj 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Hashim Çollaku, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/03/2022/ GJA-AGJ.nr.52/2022, të datës 19.05.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve dhe nenint 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 31 maj 2022, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**Hashim Çollaku**, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1 pikat 1.2 e 1.3 e lidhur me paragrafin 2 pika 2.6 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje "Këshilli"), me datë 28.01.2022 ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor duke pretenduar se Hashim Çollaku, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 1, pikat 1.2-shkel ligjin, 1.3- shkel detyrat e tij si gjyqtar, lidhur me paragrafin 2, pika 2.6-nuk raporton rastet e përjashtimit të mundshëm nga procedura kur kërkohet me ligj, dhe 2.15 –përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtoj besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Sipas pretendimit të Autoritetit Kompetent subjekti i hetimit disiplinor duke qenë kryetar i kolegjit të Apelit, në çështjen PA1.nr.1000/20, i njëjti ka vendosur përkundër faktit se bashkëshortja e tij, avokate në Prizren, kishte parashtruar ankesë e cila ishte objekt i shqyrtimit në këtë lëndë.

Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent, të fillojë hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtit, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t'i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

Kërkesës së lartë cekur Autoriteti Kompetent i' a ka bashkangjitur kërkesën e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, dhe publikimet në media e shkruara me datë 26.01.2022.

Këshilli me vendimin me numër KGJK.nr.49/2022, të datës 10 shkurt 2022, ka themeluar panelin për të shërbyer në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/03/2022/ GJA-AGJ.nr.52/2022. Paneli hetimor ja ka paraqitur Këshillit raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit të panelit hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli me datë 31 maj 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore ku morën pjesë Kryesuesja e panelit hetimor gjyqtarja Afërdita Mulhaxha dhe subjekti i hetimit disiplinore, gjyqtari Hashim Çollaku.

Kryesuesja e panelit hetimor me datë 19 prill 2022, ka mbajtur seancën e parë jo publike, në të cilën është dëgjuar subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Hashim Çollaku dhe dy dëshmitarët e rastit gjyqtar të gjykatës së Apelit, përkatësisht anëtar të kolegjit përkatës.

Provat materiale të mbledhura në mbështetje të fakteve të gjetura nga paneli hetimor kanë qenë lënda e Gjykatës Themelore në Prizren me shenjën P.nr.1934/18, sipas ankesës së pranuar në gjykatë me datë 20 tetor 2020. mbrojtëse e të dëmtuarit XH.K. nga Prizreni kishte ushtruar ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1934/18, të datës 22.09.2020. Hashim Çollaku në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues me anëtarët tjerë të trupit gjykues sipas ankesës kanë vendosur me aktgjykimin me shenjën PA1.nr.1000/20, me datë 01.02.2021, ku pjesërisht ishte aprovuar ankesa.

Subjekti i hetimit disiplinor, Gjyqtari Hashim Çollaku, ka deklaruar se këtë çështje e ka pranuar me shqetësim shumë të madh, sepse si gjyqtar me përvojë prej 36 vitesh asnjëherë nuk ka qenë në procedure disiplinore. Më tutje ka deklaruar se që nga viti 2013 është caktuar Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, ku fillimisht ka qenë udhëheqës i Divizionit Penal në Departamentin e Përgjithshëm dhe asnjëherë nuk ka pasur ndonjë parregullsi.

Në vitin 2019 është caktuar udhëheqës i Departamentit për të Mitur. Sipas subjektit të hetimit, lëndët në Gjykatën e Apelit ndahen me short. Administratori i Gjykatës i kishte ndarë lëndët në grupe dhe pastaj ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës i ndan ato për secilin gjyqtar.

Lënda kontestuese i është ndarë Gjyqtarit i cili bazuar në rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave ngarkohet me të gjitha të dhënat e lëndës. Si gjyqtar referues, Gjyqtari para trupit gjykues, Kryetar i të cilit ka qenë subjekti i hetimit, nuk e kishte bërë të ditur emrin e avokatit mbrojtës të kësaj lënde. Ai i ishte referuar avokatit me termin përfaqësues i autorizuar.

Këtë gjendje faktike, të paraqitur nga subjekti i hetimit, paneli hetimor e ka vërtetuar edhe me dy deklarata të dëshmitarëve të rastit, të cilët kanë qenë anëtarë të kolegjit përkatës për gjykimin e rastit në fjalë.

Paneli hetimor ia ka bashkangjitur raportit: deklaratat e subjektit të hetimit; deklaratat e anëtarëve të kolegjit gjykues të rastit në fjalë; aktgjykimin me shenjën P.Nr.1934/18; titujt e portaleve të



shkruara; ankesën e përfaqësueses së palës së dëmtuar të datës 28 shtator 2020; dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me numër PA1.Nr.1000/20.

Paneli hetimor i ka dorëzuar për shqyrtim dhe vendimmarrje KGJK-së këtë raport me faktet dhe provat e mbledhura, për të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtari Hashim Çollaku me rastin e nxjerrjes se Aktgjykimit PA1.nr.1000/20.

Subjekti i hetimit disiplinor në seancën dëgjimore të Këshillit të mbajtur me datë 31 maj 2022, deklaroi se në përvojën e tij 36 vjeçare si gjyqtar është hera e parë që është ardhur para Këshillit në procedurë disiplinore. Për lëndën kontestuese PA1.nr.1000/20, ka deklaruar se është pranuar nga gjyqtari [cili] edhe ka qenë gjyqtar referues. Lënda kontestuese është votuar dhe është nënshkruar nga subjekti i hetimit disiplinor në cilësinë e kryetarit të kolegjit, por i njëjti nuk ishte njoftuar nga referuesi i lëndës së kush është avokat për këtë rast por i ishte referuar vetëm me termin përfaqësuesi i autorizuar.

Me tutje subjekti i hetimit gjyqtari Hashim Çollaku ka deklaruar se ai gjithmonë kujdeset sa i përket lëndëve duke ju bërë me dije bashkëpunëtorëve profesionale dhe stafit tjetër që kur ta evidentojnë në lëndët e caktuar që bashkëshortja e tij është përfaqësuese e autorizuar të njoftohet.

Për shkak të ngarkesës me një numër të madh të lëndëve ky rast nuk është vërejtur nga subjekti i panelit, anëtarët e kolegjit dhe stafi tjetër mbështetës. Për lëndën kontestuese nuk ishte hapur seancë sepse ka qenë rasti për seancë jashtë gjyqësore, nuk ka qenë publike. Aktgjykimin PA1.nr.1000/20, e ka përpiluar gjyqtari [për] shkak të ngarkesës se madh me lëndë subjekti i hetimit nuk ka pasur mundësi që të shikoj krejt lëndën kontestuese.

Kur lënda kontestuese ishte kthyer në Gjykatën Themelore në Prizren është njoftuar nga ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës se është bërë një parregullsi. Subjekti i hetimi menjëherë kishte kërkuar nga prokuroria kompetente që të bëjnë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Ka potencuar se përgjegjësi subjektive nuk ka sepse po të ishte njoftuar nga gjyqtari referues se kush është përfaqësues i autorizuar i cilës do palë, konform ligjit do të kërkonte menjëherë përjashtim.

Pasi ishte bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për lëndën përkatëse në Gjykatën Supreme, Aktgjykimi PA1.nr.1000/20 është anuluar dhe e njëjta ka kaluar prapë në procedurë dhe për të cilën kishte vendosur një kolegji tjetër. Pasojë juridike sa i përket kësaj lëndë nuk ka pasur sepse është riparuar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Subjekti i hetimit disiplinor ka kërkuar nga Këshilli që të lirohet nga përgjegjësia disiplinore sepse nuk ka shkelje disiplinore të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për ti vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore Këshilli administroi dhe vlerësoj këto prova: Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura të panelit hetimor, dorëzuar në Këshill me datë 19.05.2022; Kërkesën e Autoritetit Kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore; Aktgjykimin P.nr.1934/18; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të paraqitur nga BIRN; Procesverbalin e panelit hetimor të datës 23 mars 2022; Transkriptin e panelit hetimor të datës 19.04.2022; Shënimet në portalet ditore te vendit; Propozimin PPA/II.nr.1013/2020 të Prokurorit të Shtetit, Prokuroria e Apelit, të datës 08.12.2020; Ankesën e datës 29.09.2020 të Myrvete Çollaku drejtuar Gjykatës së Apelit; Aktgjykimin PA1.nr.1000/20.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli në seancën seancën dëgjimore të mbajtur me datë 31 maj 2022, konstatoj se subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Hashim Çollaku, në rastin e procedimit të çështjes penale me shenjë PA1.nr.1000/20, nuk ka shkelur standardet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pikat 1.2 e 1.3 e lidhur me paragrafin 2 pika 2.6 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve.

Këshilli ka gjetur se subjekti i hetimit gjyqtari Hashim Çollaku nuk është përfshirë në shkelje disiplinore me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes në çështjen penale PA1.nr.1000/20. Sipas të gjeturave të vërtetuara me fakte dhe prova nga ana e Këshillit lënda PA1.nr.1000/20 i kishte ndarë gjyqtarit i cili ka qenë edhe gjyqtar referues. Gjatë referimit të lëndës kontestuese, gjyqtari i lëndës nuk ja kishte deklaruar emrin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, në këtë rast avokates e cila është edhe bashkëshortja e subjektit të hetimit, ankesa e se cilës ka qenë duke u trajtuar.

Si rrethanë për lirim nga përgjegjësia disiplinore të subjektit të hetimit Këshilli mori edhe faktin se nga prokuroria kompetente ndaj Aktgjykimit PA1.nr.1000/20, ishte parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për të cilën kishte vendosur Gjykata Supreme, dhe ka anuluar aktgjykimin. Lënda kontestuese ishte kthyer në procedurë për të cilën ka vendosur një kolegji tjetër dhe se në këtë rast nuk ka pasur kurrfarë efekti juridik.

Shkeljet e pretenduara nga Autoriteti Kompetent nuk janë provuar me provat e administruara të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i panelit hetimor. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi paneli hetimor në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim, me shumicë të votave vendosi që subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Hashim Çollaku nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent dhe të njëjtën e ka liruar nga përgjegjësia disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.277/2022, datë: 31 maj 2022**

Qerim ADEMAJ

Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Valon Totaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit;
- Hashim Çollaku, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit;
- Arkivit.

